



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/49

Datë: 08.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 30.3 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-221, Ligjin 04/L- 116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr 05/L- 063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për transferim të mjeteve nga nën programi Zhvillimi i Resuseve Njerzore në KPSH me kod 71000, kategoria e shpenzimeve, shpenzime kapitale, nga projekti me kod 13846 "Ndërtimi i objektit të Spitalit në Ferizaj, në shumë prej pesqindenjëzetëeshtatëmijë e njëqindpesëdhjetëekatër euro (527,154 €), burimi i financimit të hyrat e AKP-së.
2. Mjetet në shumë prej 527,154 € (pesqindenjëzetëeshtatëmijë e njëqindpesëdhjetëekatër euro) nga pika 1. e këtij vendimi transferohen në këto nën programe:
 - 2.1. Në nën programin Programi i Shëndetit Publik me kod 71100, shuma prej 477,154 € (katerqindeshtatdhjetëeshtatëmijë e njëqindpesëshjetëekatër euro), në kategorinë e shpenzimeve, shpenzime kapitale në projektin me kod 18541 "Pajisje mjekësore për Departamentin e Mikrobiologjisë dhe Labororet Testuese" burimi i financimit të hyrat e AKP-së;
 - 2.2. Në nën programin Departamenti Shëndetësor i Burgjeve me kod 72600, shuma prej 50,000 € (pesëdhjetë mijë euro), në kategorinë e shpenzimeve, shpenzime kapitale, në projektin me kod 15744 "Shërbimi Shëndetësor i Burgjeve, kapitale pajisje" burimi i financimit të hyrat e AKP-së.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/49

Datë: 08.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 dhjetor 2020, merr këtë:


V E N D I M

1. Autorizohet Ministri i Shëndetësisë për nxerrjen e Rregullores për kushtet, kompensimin, dhe procedurat tjera tjera për angazhimin e përkohshëm të profesionistëve shëndetësor dhe stafit mbështetës gjatë pandemisë COVID - 19 duke tejkaluar të gjitha procedurat që përcaktohen me Rregulloren nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Rregulloren nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe procedurat tjera të përcaktuara me dispozitat ligjore për rekrutim.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Duke ju referuar kërkesave në rritje për angazhimin e përkohshëm të profesionistëve shëndetësor dhe stafit mbështetës gjatë pandemisë COVID-19, për shkak se Klinikat e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar janë të stërngarkuara me pacientë të infektuar me COVID-19 dhe poashtu profesionistët shëndetësor janë të infektuar me COVID-19, është e domosdoshme të nxirret Rregullorja për kushtet, kompensimin, dhe procedurat tjera tjera për angazhimin e përkohshëm të profesionistëve shëndetësor dhe stafit mbështetës gjatë pandemisë COVID - 19, duke shkurtuar të gjitha procedurat dhe afatet ligjore që përcaktohen me Rregulloren nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rregulloren nr.13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe procedurat tjera të përcaktuara me dispozitat ligjore për rekrutim si dhe në zbatim të nenit 21 të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Covid -19 në Territorin e Republikës së Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/49

Datë: 08.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 13, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 07/L-001 mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 si dhe Ligjin Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me Nr.07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet metoda e pagesës direkte (UN Advance) në formë të avancit tek UNOPS, në emër dhe për llogari të Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe regjistrimi kontabël në SIMFK në kodin përkatës të avancit për pagesa direkte të huamarrjes, në vlerë prej 7.971.043.11 euro, në bazë të kredisë së ratifikuar me Ligjin Nr. 07/L-017 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me Financimin e Projektit Emergjent Covid-19 për Kosovën, si dhe bazuar në Marrëveshjen në mes Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës (MSH) dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS).
2. Avanci i regjistruar nga pika 1. e këtij vendimi, bartet në vitin e ardhshëm fiskal dhe mbetet i hapur në një afat prej 7 muaj dhe do të mbyllet, përkatësisht arsyetohet nga Ministria e Shëndetësisë ashtu siç pranohen faturat dhe pajisjet e porositura sipas procedurave të blerjes së pajisjeve mjekësore, subjekt i kësaj marrëveshje, por jo me vonë se 30.06.2021.
3. Autorizohet dhe obligohet Ministria e Shëndetësisë që të ndërmarrë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për zbatimin e ratifikuar me Ligjin Nr. 07/L-017 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim Lidhur me Financimin e Projektit Emergjent Covid-19 për Kosovën, si dhe bazuar në Marrëveshjen në mes Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës (MSH) dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS).
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh që Marrëveshja në mes Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës (MSH) dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS) e cila buron nga Ligji Nr. 07/L-017 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me Financimin e Projektit Emergjent COVID-19 për Kosovën parasheh prokurimin e pajisjeve mjekësore për parandalimin dhe luftimin e

pandemisë COVID-19, marrë parasysh rregullat e disbursimit dhe prokurimit të Bankës Botërore të cilat janë pjesë e marrëveshjes së ratifikuar që cekin aranzhimet e veçanta të projekteve me agjencitë e UN-it, mundësin e pagesës në avans si dhe në zbatim të nenin 13, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 dhe Ligjin Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me Nr.07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/49


Datë: 08.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes dypalëshe ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut mbi Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim Ksv /017: Programi për Mbështetjen e Shëndetësisë në Kosovë, (Faza II).
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Shëndetësisë obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë